



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT
BORDI

Nr. 213/prot
1

Tiranë më 15/07/2025

PROCESVERBAL
MBLEDHJE BORDI
(Datë, 11/07/2025)

Të pranishëm nga Bordi: Z.Vasil Tole, Z.Mentor Beqa, Znj.Alma Mirakaj, Znj.Etleva Smaçi, Z.Simon Mirakaj, Z.Niuton Mulleti, Znj.Laureta Roshi.

Rendi i ditës:

1. Diskutimi dhe miratimi i Kolanës së Botimeve të vitit 2025 .

Mbledhja hapet nga Kryetari i Bordit z.Mentor Beqa

M.Beqa: Para se të fillojmë me diskutimet, dua të pyes nëse Këshillit i janë dërguar librat sikurse u diskutua mbledhjen e kaluar dhe nëse ata kanë sjellë një relacion për botimet?

Këshillit i janë dërguar librat, por nuk kanë kthyer një përgjigje.

M.Beqa: Këshilli i ri nuk ka kthyer një përgjigje, Këshilli i kaluar ka bërë detyrën e vet, ka dhënë vlerësimet , ka bërë relacionin dhe nëse do t'i japim kohë edhe Këshillit të ri, nuk i dihet se sa kohë do, kështu që është e sigurt nëse ndjekim këtë rrugë, botimet do të dështojnë. Vaso ke ndonjë gjë, pasi ju e propozuat që librat t'i dërgoheshin edhe këtij Këshilli?

V.Tole: Jo, nuk kam ndonjë gjë. Ne e bëmë detyrën si Bord. Mendoj të vazhdojmë.

M.Beqa: Po e hap diskutimin, kush ka për të diskutuar?

V.Tole: Në përgjithësi bie dakort me librat e propozuar , por kam dy sugjerime.

Së pari, te pika 2, "Skënder Muço: Kontributi politik dhe patriotik" i autorit Enver Lepenica, e njoh, është një autor shumë i mirë, do të propozoja që ky titull t'i ndryshohet, pasi nuk është tipik për botime institucionale, pasi është emocional që në titull.

M.Beqa: Edhe mua më bëri përshtypje ky titull dhe propozoj që të ndryshohet.

V.Tole: Te pika 4, ka një monografi kushtuar Enver Hoxhës. Doja të pyesja Drejtorin kush është autori, nëse ky i ka kapacitet shkencore për të përballuar një monografi për autorin?

Ç.Hoxha: Luan Dode është një studiues shumë serioz. Ai ka botuar me ne edhe para disa vitesh një botim shumë serioz për Partinë Komuniste. Besoj te puna që ai bën. Këshilli e ka miratuar për botim. Konsideratat e mia për të janë që ai është ndër studiuesit më seriozë.

M.Beqa: Të dyja pikat janë pika që do t'i shqyrtojmë se dhe mua më kanë bërë përshtypje.

V.Tole: Unë vetëm këto kisha.

E.Smaçi: E para, dua të them që ky është një vit i ngarkuar dhe unë do ta pranoj këtë procedurë si është, pasi nuk dua të digjen buxhete. Në mënyrë të veçantë, e lexova rregulloren për të parë se kush ka të drejtë të botojë. Nga eksperiencia, di që botimet kanë një procedurë shumë të thellë. Kam respekt shumë për Indritin, por e kuptoj që e ka bërë relacionin në kushtet kur ia kanë ngarkuar këtë detyrë për ta bërë, pasi një reçencë duhet të ketë të paktën 10 faqe A4 në formatin e duhur, por unë e kuptoj që i ka ngelur në qafë dhe ka bërë nga një paragraf.

E dyta, jam shumë dakort edhe duke u bazuar në pjesën e memuaristikës që ju botoni nga ata që kanë një status si i përndjekur politikë që kanë vuajtur, por kur vjen rasti të botime të kësaj kategorie të monografisë, po ju kujtoj vetëm një detaj, i vetmi problem që ngriti Fischeri kur u ftua me rastin e 20 shkurtit vitin e kaluar tha: Shqipëria nuk ka arritur gjithë këto vite të ndërtojë një monografi për Enver Hoxhën. Autori mund të jetë ekselent, unë kam bërë kërkime në internet, pasi nuk e njoh. E para, unë mendoj që një biografi politike duhet të vijë nga një grup autorësh, pasi nuk ka asnjë autor sot që të pretendojë që ta njohë Enverin në të gjitha periudhat. Studiuesit ndahen në periudha, nuk janë gjithëpërfshirës. Ndaj, mendoj që këtë zotërinë, aq më tepër që Çelo nuk e ka lexuar, edhe ne s'e kemi lexuar, të lihet për vitin tjetër.

Mendoj që një monografi e këtij niveli nëse ISKK do të tentojë ta bëjë dhe duhet ta bëjë, por duhet të vijë me figurat më të spikatura të historiografisë shqiptare, por jo vetëm kombëtare, por edhe jashtë, ku mund të përfshihet Fischerin, Midin etj. Nuk jam për të dalë vetëm me një autor, i cili nuk ka as një emër, nuk ka asnjë citim.

Përfundimi është që kjo monografi të lihet jashtë botimeve të këtij viti sepse nuk e ka lexuar as Drejtori vetë dhe as ne, pasi përveç përgjegjësisë financiare, është edhe përgjegjësia morale.

Sot nuk do të merrem si e përmenda, por herët e tjera, unë dua të gjithë dosjen e autorëve që nga fakti pse ata janë nisur të bëjnë një studim, kush është fusha e interesit të tyre, dhe e treta, është për të drejtën e autorit për mënyrën sesi shpërblehen, këto duhet të jenë në dosje. Për të tjerat, nuk kam diçka për të shtuar.

M.Beqa: A ka peer review për veprat, a e merr librin një personalitet i fushës dhe ta shqyrtojë atë?

Ç.Hoxha: Jo, nuk ka, këtë e bën Këshilli Shkencor për secilin libër.

M.Beqa: Këshilli e ka të pamundur që ta bëjë këtë me pagesën që i jep instituti, pra botimet kalojnë pa pasur një filtër shkencor profesional të autoriteteve të fushës. E di që pengesa kryesore për këtë është pagesa dhe mendoj se duhet gjetur mënyra sesi ata që merren me oponencën shkencore të paguhet. Duhet të ulemi dhe ta diskutojmë në një moment tjetër këtë çështje dhe e dyta, botimet për vitin tjetër duhet të na vijë sivjet, që ne të kemi mundësi ta shqyrtojmë që të kemi mundësi ta miratojmë vitin tjetër.

E.Smaçi: Çështjen e pagesës e zgjidh VKM 120 që e ka përmendur edhe Drejtori në relacion. Plani për botimet duhet të na vijë në nëntor që ta kemi për vitin tjetër për miratim.

M.Beqa: Kush ka tjetër për të diskutuar?

L.Roshi: Më falni për vonesën, nuk kam gjë për procedurën. Unë kërkoja të kisha jetëshkrimet e autorëve të librave dhe e dyta, doja të pyesja, ju të tjerët, se unë veten time e di, keni raporte me Çelon si Drejtor dhe me Institutin? Keni marrë financime për botimet, për vajtjet në konferencë, keni interesa të ndërthurura, ndonjë familjar të stimuluar gjatë një viti?

Pasi e lamë që do ta bënim mbledhjen të akademisë vjen një urdhër nga kryetari që do ta bëjmë në ISKK, vjen një procesverbal me vonesë dhe unë atë ditë e kam mbajtur procesverbalin në telefonin tim dhe shoh që nuk përkon me atë që mua më erdhi. Unë e bëra korigjimin tim dhe faleminderit ty për mbështetjen që unë mund ta bëja nga telefoni.

Do të doja që edhe jashtë ISKK të ishte një tabelë më e dukshme. Unë kur e pranova këtë detyrë nuk e pranova për atë honorarin që unë do marr, por mora pjesë për atë ngjyrimin emocional që ka Instituti dhe mënyra sesi punohet dhe nuk kalohet te publiku një gjë që të ketë jetëgjatësi. Nuk dua të jem një person që firmos një procesverbal dhe marr një honorar në këto mbledhje. Mendoj që sekretarja meqë është edhe sekretarja e Drejtorit nuk ka pse të jetë edhe sekretarja e Bordit.

M.Beqa: Provesverbali është përmbledhje e atyre që ne themi, por të merren në konsideratë ato që tha znj.Lori

E.Smaçi: Mendoj se ka një përplasje. Mendoj se sekretaren e zgjedh Bordi. Ne e diskutuam edhe me Liljanën që kishte dashur ta përmbledhte, por ndodh që përmbledhja ndryshon dhe kontekstin.

M.Beqa: Patjetër që e zgjedhim ne dhe sekretaren.

Ç.Hoxha: Unë dua të them diçka meqë u përmend emri im diçka në lidhje me anën financiare.

L.Roshi: Pyetja ishte për anëtarët e Bordit, jo për ty.

Ç.Hoxha: Ishte një akuzë për mua.

M.Beqa: Nuk ishte një akuzë.

E.Smaçi: Pyetja ishte për ne nëse kemi qënë përfitues, duam që këto mbledhje të jenë sa më etike se tensionohemi, pëlqej të punoj në një klimë miqësore dhe jo në një klimë armiqësore.

S.Mirakaj: Nuk jemi armiq me njëri-tjetrin, jemi miq. Gjërat do t'i zgjidhim në bashkëpunim. Nuk duhet ta shohim njëri-tjetrin me syrin e armikut. Unë i bëj thirrje edhe drejtorit, por njëherë stafi duhet ta dijë që ka një drejtor dhe ta respektojnë si drejtor, por edhe drejtori duhet të ndyshojë formën e komunikimit me stafin.

N.Mulleti: Të jem i singertë, këtë e shpreha dhe në fund të mbledhjes së kaluar, por e mirëkuptoj Liljanën për ngarkesën që ka, nuk më duket aspak normale që tre anëtarë të Bordit u larguan nga mbledhja pa përfunduar mbledhja. Mund të kishit rezervuar të drejtën e mosmarrjes pjesë në votim e të qëndronit deri në përfundim të mbledhjes. Të gjithë kemi angazhimet tona profesionale dhe personale. Kjo ishte për transparencë meqë tre anëtarët nuk ishin deri në fund të mbledhjes dhe unë e shpreha këtë në mbledhjen e kaluar.

E.Smaçi: Unë jam larguar jo për arsye personale, por sepse u kërkuam me imponim që të votohej një gjë që unë nuk jam dhe sot e qartë juridikisht.

M.Beqa: Bordi është organ kolegjal dhe mund të votojë, këto janë rregulla si funksionojnë Bordet.

N.Mulleti: Ju mund të mos kishit marrë fare pjesë në votim.

E.Smaçi: Unë mund të votoja pozitivisht sipas qasjes juridike dhe negativisht sipas qasjes juridike.

N.Mulleti: Mund të kishit pritur deri në fund për të parë ecurinë e mbledhjes.

L.Roshi: Mos t'i kthehemi përsëri atij diskutimi z.Mulleti se në fillim, të gjithë e kemi dashur z.Çelo drejtor.

N.Mulleti: Mua nuk më intereson fare ajo çështje, mua më intereson etika e mbledhjes.

L.Roshi: Kur e diskutuam në fillim atë fakt dhe unë kërkova një jurist të jashtëm kur erdhi emaili dhe ju thashë juve ndajeni më vete z.Çelo, mos t'ia pranojë dorëheqjen atij tjetrit, ta zgjidhin këtë situatë me mirëkuptim dhe me kulturë komunikimi dhe kjo gjëja nëse është e vërtetë, më e pakta që të bënte, ta kishte shkruar në jetëshkrimin e tij. Këto mendoj unë, pasi është një institucion i rëndësishë së veçantë. E mbyllëm këtë diskutim, por të kuptohemi që nuk mund të mbyllim diskutimet dhe të vërtetat përmes mekanizmit votë.

Ajo është votë, shumë mirë të shkruhet si është e zeza mbi të bardhë dhe kaq.

N.Mulleti: Kur vijmë te përmbajtja e procesverbalit, kush është marrë me mbajtje procesverbali, e di shumë mirë se sa punë e vështirë është, edhe për kushtet e institutit, edhe për kushtet në të cilat është znj.Liljana. Procesverbalet janë dërguar në çdo moment në kohë të arsyeshme, përveç këtij të fundit, ku na shpjegoi arsyen. Mirë është të përgatiten më shpejt kur janë dhe rrethanat e përshtatshme. Na dërgoni dhe procesverbalin e datës 3 qeshor kur u bë votimi që ta kemi për informacion. Procesverbali dërgohet që ne ta shohim, ta shqyrtojmë dhe të reagojmë nëse ka nevojë për ndryshime, përmirësime apo heqje, gjë që unë e kam bërë në disa raste, qoftë edhe për gjëra gramatikore, sepse është një dokument shumë i rëndësishëm që mban nënshkrimet tona.

E.Smaçi: Unë dua të shpjegoj një gjë që të jesh i qartë. Unë nuk do t'ia lejoja vetes që të lija një mbledhje dhe të shkoja të bëja diçka tjetër, nuk ishte kjo. Unë vetë jam shprehur qartë nga fillimi deri në fund, kështu kam nisur fjalinë se nuk do të kisha dashur kurrë, pasi është zgjedhur një drejtor, të ndodhesha në pozitë e t'i thosha një drejtori të zgjedhur, sepse nuk ma pranon etika profesionale, që një njeri që është i zgjedhur, t'i thuhet largohu. E kam thënë që problematika ka filluar me burimet njerëzore. Në këto kushte, unë thjesht kam kërkuar që të qartësohem vetë juridikisht, kjo ka qenë fjala e fundit që kam thënë.

M.Beqa: Kjo është e vërtetë. Problemi qëndron se ky është një organ kolegjal, kur hyn në ngërç, ka një mekanizëm dhe ky mekanizëm është vota. Ne nuk do e kishim zgjidhur atë çështje nëse ne nuk do të shkonim drejt votës. Ishte e pamundur, pasi qëndrimet tona ishin të kundërta, nuk kishin përputhje me njëra-tjetrën, kështu e vetmja mënyrë ishte për të përdorur atë mekanizëm që na ka dhënë ligji që është vota. Natyrisht, nuk ka pse të largohen njerëzit, pasi dikush voton kundër, dikush abstenon apo dikush voton pro.

L.Roshi: Pse duhet të vijmë te procesi i votës, votimi është bërë çdo sekond. Cilësia e bisedës ishte që ne të gjenim një hapësirë komunikimi. Ti e anashkalove komplet shqetësimin tim për raportin e drejtorit me punonjësit e institutit e për shumë gjëra që unë po i sillja shumë çiltërsisht.

Ti i anshkalon të gjitha dhe i mbyll me një votim në fund, mbylle me votim si të gjithë dhe dimë që kur mbyllet me votim kundër apo pro, shkruajmë dhe argumentat dhe jemi të gjithë të qetë. Por kam ardhur në këtë Bord me shumë mirëdashje, kam ardhur që ai gjaku i heshtur të mos jetë gjak i heshtur.

M.Beqa: Të vendosim disa rregulla dhe të flasim me radhë. E mbyllim diskutimin për mbledhjen e kaluar dhe të vazhdojmë me rendin e ditës. Ka dikush për të shtuar?

N.Mulleti: Nga ana teknike njëherë, ka mospërputhje në emrat e autorëve, mes tabelës dhe mes relacionit. Edhe për titujt e veprave, dua të jem i sigurt që këto do të jenë titujt përfundimtarë. Fillojmë me emrat e autorëve, te tabela është Enver Lepenica, te relacioni është Enver Memishaj, nëse autori përdor dy mbiemra, mund t'i përdorni të dy. Për z.Luan Doda nuk gjeta asnjë informacion thelbësor që të mund të na ndihmojë për të marrë një vendim. Ne nuk kemi lexuar asnjë nga këto libra, por fakti që është monografi, duhet ta shqyrtojmë me detaje. Te tabela është Musa Çapani, te relacioni Musa Çepani. Autori Xhezo Cana te tabela, në Google më dilte Xhezo Canaj.

Për përmbajtjen, besoj jemi të vetëdijshëm që jemi në kushtet që jemi shumë të vonuar për të marrë një vendim, është pak a shumë një vendimmarrje e imponuar, por brenda këtij konteksti, mund të përmirësojmë këto gjërat e vogla që mund të përmirësohen. Edhe për titullin Skënder Muça, kjo pjesa duhet hequr, por gjithësesi duhet të jemi të sigurt që këto janë versionet përfundimtare të titujve.

E.Smaçi: I ke parë këto dokumentat e Kënetës së Maliqit, pasi ka shumë dokumente të botuara?

Ç.Hoxha: Jo, nuk i kam parë.

E.Smaçi: Të lutem shikoji se kur thua dokumente, ti e di si reagojnë njerëzit nëse dikush e ka botuar më parë këtë dokument.

Ç.Hoxha: Ne kemi botuar gjyqin e Maliqit dhe këto janë tjetër gjë.

E.Smaçi: E di që ti vetë nuk mund t'i kalosh të gjitha, por mund të vendosësh një nga punonjësit që t'i bëjë një kontroll para se të kalojë te botimi. Ai mund ta përdorë, por ta përmendë që e ka thënë një autor tjetër më para, që të mos dalë sikur i ka dokumente të tija, pasi është problem i madh nëse nuk i ka të tija dhe nuk i citon.

Ç.Hoxha: Unë nuk mund të kontrolloj të gjitha dokumentat, por autori bën një deklaratë origjinaliteti. Gjithashtu, nëse është botuar, ka një mekanizëm Biblioteka përmes ISBN.

E.Smaçi: Nuk mund t'ia lëmë Bibliotekës këto.

M.Beqa: Me sa pashë unë, të gjithë bien dakort në dy pika:

E para, është ai titulli Skënder Muço që të ndryshohet,

E dyta, është biografia e Enver Hoxhës dhe unë bie plotësisht dakort me çfarë u diskutua.

E.Smaçi: Është shumë sensitive.

L.Roshi: E para, duhet thënë ish-diktatori. Gjuha e shprehur është gjuha e të menduarit, ai është diktatori Enver Hoxha.

M.Beqa: Ky nuk është një tekst zyrtar që ne të mbledhim një grup autorësh që ne të bëjmë një tekst zyrtar për Enver Hoxhën. Ka perspektiva nga më të ndryshmet për figurën e tij. Besoj se autorët duhet të jenë autorë seriozë që duhet të merren me këtë çështje. Ai zotëria mund të jetë

një autor i shkëlqyer, por të shkojë ta botojë në një shtëpi botuese. Instituti duhet të ketë referenca shumë serioze në botim, nëse ai është kaq serioz, e lëmë për vitin tjetër, e fusim në peer review nga një autoritet i fushës. Nëse ai autoritet na sjell një referencë serioze që e mbështet punën e tij, e botojmë për vitin e ardhshëm. Unë them për këtë vit ta mënjanojmë nga plani i botimeve, nëse kam mbështetjen e të gjithë anëtarëve.

N.Mulleti: Është shumë e rëndësishme që të qartësohet kjo pjesa e titujve dhe emrave, pasi kjo mospërputhshmëri tregon për paaftësi të Këshillit, ndoshta dhe në rrethanat që është gjendur të bëjë një referencë shkencore ose gati shkencore, ndoshta nuk e ka dhe detyrë funksionale ta bëjë.

M.Beqa: Këshilli duhet të veprojë mbi oponencat. Të bëhet një procedurë si e kanë dhe të gjithë shtëpitë botuese. Në fund i çohet Këshillit Shkencor dhe ne jemi hallka e fundit.

E.Smaçi: E përmenda që për vitin tjetër duhet të kemi një procedurë shumë të detajuar.

A.Liço: Për ecurinë e mbledhjes së sotme, unë isha e qartë që do të shkonte kështu siç shkoi për problemet e mbartura nga mbledhja e kaluar. Për atë që ne duhet të bëjmë, se sot jemi para faktit të kryer që na janë dhënë disa tituj që dhe ato kanë kontradiktat e veta, nga një relacion shumë të shkurtër dhe ndaj është e pamundur që ne të gjykojmë. Është një votim i vështirë, pasi për hir të mungesës së kohës, ne duhet t'i pranojmë. Unë jam shumë dakort për heqjen e monografisë së Enver Hoxhës. Ai vërtet duhet parë shumë seriozisht, ndaj jam shumë dakort që të shikohet për vitin e ardhshëm. Për këto të tjerat, jam dakort për arsyet që i thamë, do t'i kalojmë.

M.Beqa: Të rregullohen ato mospërputhjet që na kanë ardhur, të rregullohet titulli i librit që u diskutua dhe të hiqet nga plani i botimeve të vitit 2025 libri i autorit Luan Doda për të cilin ramë dakort. Jeni dakort me të gjitha këto?

S.Mirakaj: Mua nuk më intereson fare ajo monografia. I kam hequr në kurriz, ndaj nuk dua fare të botohet as për vitin tjetër.

L.Roshi: Edhe unë jam dakort që kjo monografi mos të botohet këtë vit, as të shtyhet për vitin tjetër.

Anëtarët janë dakort për mosbotimin e këtij libri.

Ç.Hoxha: Dua të flas për çështjen e honorareve, e kisha shpjeguar te një pjesë e relacionit nëse e keni parë.

M.Beqa: Me këtë çështje do të merremi në shtator.

E.Smaçi: Në shtator do të merren disa sugjerime dhe të arrihet në konkluzion për Rregulloren e Botimeve.

L.Roshi: Me këto vepra që ne miratuam sot, del fondi që ne të jemi në rregull me ligjin?

Ç.Hoxha: Në planin vjetor buxhetor bëhet parashikimi i përafërt dhe ne jemi aty aty me parashikimet.

M.Beqa: Librat u miratuan, me ndryshimet që u diskutuan. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Pasi u mbyll mbledhja, Drejtori Z.Çelo Hoxha iu paraqiti anëtarëve të Bordit Relacionin e diskutimeve me titull "Raport për projektligjin "Për krijimin e Institutit të Studimeve të Krimeve dhe të Pasojave të Komunizmit në Shqipëri", të marrë nga Kuvendi.

Mentor Beqa.....

Simon Mirakaj.....

Vasil Tole.....

Etleva Smaçi.....

Loreta Roshi.....

Alma Mirakaj.....

Niuton Mulleti.....

Mbajti Provesverbalin: Liljana Aliko

